

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“XBOUNDBUSINESS” SHPK**

Ne Tirane, sot me date 10.12.2024, me cilesine e “ortakut themelues “ une: Paolo Cotroneo, shtetas Italian, i datelindjes 20.11.1965, madhor, me zotesi jurdike dhe per te vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit, Nr. 1346 , me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjin 9723 date 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, Kodin Civil te RSH, vendosa te themeloj dhe te hartoj statutin e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“XBOUNDBUSINESS” shpk**, (me poshte e quajtur “Shoqeria ”)

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **“XBOUNDBUSINESS”** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”),

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria **“XBOUNDBUSINESS”** shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i vetem”, i cili nuk përgjigjet pér detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore , ne adresen: Rr. “BARDHOK BIBA”,
Z.K. 8360 Vol. 92, F2 111, SIP. GALERIA 17 Nentë Tirane.

Posta elektronike: Paolo.cotroneo@gmail.com

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.



Neni 4

Objekti i veprimtarise:

Shërbime riparimi per Personal Computer (hardware/software) dhe pajisje elektronike per zyra e te ndryshme. Shërbime ndermjetesimi per tregtim, import/eksport te pajisjeve bujqesore si dhe sherbime riparimi asistence per te njejtat pajisje. Agjenci udhetimi. Ndërmjetësim në tregun e punës. Shërbime konsulence për të gjitha llojet e sigurimeve. Konsulencë dhe ndërmjetësim në sektorin e pasurive të paluajtshme. Shërbime të formimit profesional në fushën e pasurive të patundshme. Shërbime projektimi dhe konsulence për përdorimin e programeve speciale për programim kompjuterik. Shërbime të formimit profesional në fushën e dizajnit. Konsulencë dhe asistencë për arredimin e brendshëm të shtëpisë dhe çdo ambienti tjeter. Vlerësime të pasurive të patundshme. Shërbime përkthimi juridik dhe letrar në gjuhë të ndryshme (anglisht, italisht, spanjisht, greqisht, gjermanisht). Shërbime të ndryshme konsulence dhe ndërmjetësimi për realizimin e shërbimeve sipas marrëveshjeve të dakordësuara me klientët. Import-eksport i produkteve bujqësore/ushqimore dhe konsulencë në fushën e agronomisë dhe kulturave bujqësore. Fushata publicitare dhe marketingu, import-eksport të mallrave të lëvizshëm, konsulencë për sektorin ho.re.ca (hotel, restorante, kafeteri). Aktivitet për dhënie me qira të makinave.

Neni 5

Kohezgjatja:

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar:

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga "ortaku i vetem" i shoqerise :

Paolo Cotroneo, eshte zoterues i 1 kuote me vlore 100.000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.



Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit:

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit, për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit ”.

Neni 8

Transferimi i kapitalit:

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Nenⁱ 9

Organë Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistrer të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mëritë besim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrëthanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator e e shoqerise eshte, **Paolo Cotroneo**, identifikuar me ID., nr. 1346.

- Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka tё drejtё e detyrohet tё:

- a) kryejë tё gjitha veprimet e administrimit tё zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare tё shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tё vendosura nga ortaku i vetem;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pёr mbajtjen e saktë e tё rregullt tё dokumenteve dhe tё librave kontabёl tё shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pёr shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin kёto dokumente pёrpara ortakut te vetem pёr miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmёrimi nё kohën e duhur pёr rr Ethanat, që kërcёnojnё mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj tё dhënat e detyrueshme tё shoqërisë, siç parashikohet nё ligjin pёr Qendrën Kombëtare tё Regjistrimit;
- e) raportojë pёrpara asamblesë së përgjithshme nё lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tё posаçme me rëndësi tё veçantë pёr veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar tё thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve tё ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qё aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnё detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve nё vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve tё para pas regjistrimit tё tij, propozon tё blejë nga një ortak pasuri, qё kanë vlerë mё tё lartë se 5 pёr qind tё aseteve tё shoqërisë, qё rezulton nё pasqyrat e fundit financiare tё certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e



lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprinë të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rrith shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevi ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e tij;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.


Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvèçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet



sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20


Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare e Biznesit, për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”.

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:



1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut te Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësish dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tij në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe qfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Statut i shoqerise "**XBOUNDBUSINESS**" shpk, u redaktua nga une "ortaku themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtajuridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejtajuridike.

ORTAKU I VETEM
"XBOUNDBUSINESS" shpk

Paolo Cotroneo

